

Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës  
Association of Independent Broadcast Media of Kosovo  
Asociacija Nezavisnih Elektronskih Medija na Kosovu

Prishtinë,  
23 janar 2015

**KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA**  
Prishtinë

**Lënda: Propozimet dhe kërkesat e AMPEK-ut për draft strategjinë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës**

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Të bashkëngjitur keni komentet e AMPEK-ut në draftin e "Strategjisë për Kalim në Transmetim Digjital Tokësor në RKS "( Dhjetor 2014).

Në pjesën e dytë gjeni shkrimin që pasqyron vizionin e AMPEK-ut në lidhje me digjitalizimin në Kosovë.

Me këtë rast do të doja të cekja se ky është dokument i harmonizuar nga anëtarët e AMPEK-ut, asociacionit që mbledh rreth vetes 79 anëtarë, transmetues lokalë, rajonalë dhe nacionalë.

Ju falënderoj për bashkëpunimin.

Me nderime,

**Ardita Zejnullahu**  
Drejtoreshë ekzekutive  
AMPEK

## **PJESA E PARË - KOMENTET DHE PROPOZIMET E AMPEK -ut**

### *1). Të riformulohet qëllimi i Ligjit për digjitalizim.*

Qëllimi i Ligjit për Digjitalizim duhet të jetë i natyrës teknike, dhe jo të ndërhyjë në politikat e transmetimit dhe të planifikimit të rrjeteve, që janë kompetencë e KPM, e definuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për KPM-në. (Kushtetuta e Kosovës, neni 141. Ligji për KPM-në).

Ligji duhet ta azhurnojë spektrin e transmetimeve, duke rialokuar bandin mbi 800 Mhz, si dhe të rregullojë procedurat e tenderimit të Multiplekseve, pa ndërhyrje nga qeveria apo parlamenti gjatë procesit të licencimit. Rregullimet e tjera bëhen me akte nënligjore të KPM-së.(Fq.5)

*2) Në Strategjinë për Kalimin në transmetim digjital tokësor, (faqe 8, kapitulli "SEKTORI MEDIAL NE KOSOVË") mungon analiza e tregut, që përfshin edhe prezentimin e pronësisë së operatorëve aktualë në platforma të ndryshme (transmetuesit aktualë analogë dhe operatorët e rrjeteve kabllore), pjesëmarrjen e tyre në treg përmes platformës tokësore dhe kabllore (Ndërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme të Tregut - FNT ). Po ashtu mungon plani për parandalimin e monopolit dhe koncentrimin të pronësisë, i cili duhet të jetë pjesë e Strategjisë për digjitalizim dhe Ligjit për Digjitalizim.*

Arsyetim:

Në direktivën 2002/21 EC, e kornizës së rrjeteve për komunikime elektronike, e amenduar me direktivën 2009/140 EC, tek definicionet (27) thuhet se “Rregullatori i vendit duhet të bëjë analizën nëse produkti apo shërbimi në treg është konkurrent në tregun përkatës ose zonë gjeografike. Analiza e konkurrencës duhet të përmbajë analizën nëse tregu është me perspektivë konkurrense, apo nëse mund të paraqitet mungesë e qëndrueshme e saj”.

*3) Faza e parë - Periudha transitore të nis me periudhën "simulcast" apo transmetim paralel analog dhe digjital të transmetuesve aktualë në Kosovë, menjëherë pas miratimit të kësaj strategjie nga KPM. KPM duhet të hartojë një Rregullore të posaçme për këtë fazë, me të cilën rregullohet transmetimi testues i kombinuar analog dhe digjital, pa interferenca dhe në baza jodiskriminuese. (faqe 36 e "Strategjia..", Kapitulli "PROCESI I IMPLEMENTIMIT TE TELEVISIONIT TOKËSOR DIGJITAL NË KOSOVË")*

#### Arsyetim:

Në bazë të rekomandimeve të KE dhe udhëzuesve të ITU, OSBE dhe DigitAG, gjatë procesit të kalimit nga transmetimi analog në digjital, rregullatori duhet të sigurojë që ky proces mos ta çrregullojë tregun (Market disturbance and failure). Në mënyrë që kalimi në DTT të jetë i suksesshëm, ai duhet të jetë i pranueshëm nga publiku, i cili tashmë ka krijuar shprehinë e shikimit të kanaleve "historike" apo transmetuesve analog të licencuar në Kosovë. Sipas definicioneve të ITU, edhe transmetuesit komercial-privat, që janë licencuar me skemë programore e cila, pjesërisht apo plotësisht ka përbajtur për shërbim të publikut (programe informative dhe kulturore), kategorizohen si PSB (Public Service Broadcasters).

#### REFERENCË:

ITU GUDIELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 130, REQUIRED PSB SERVICES, PIKA 3) "If a simulcast period is required: the Government and/or Public Service Broadcaster might require a 'simulcast' period, allowing analogue viewers to switch to an alternative television platform. A simulcast period is however not necessarily required in each geographical area or for all PSB services<sup>184</sup>,"

REFERENCË" ITU GUDIELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 30, LICENCIMI I TRANSMETIMIT PER SHERBIM PUBLIK)

"The Regulator can organize PSB in different ways, depending on the way (a part of) the PSB is funded<sup>(43)</sup>. In practice two basic forms can be found, which can change or be combined over time:

1. A PSB entity is established by Government, with defined PSB services, fully or partly funded by public sources (either licensing fees and/or general taxes);
2. A commercial/private broadcaster was established, (fully) funded by commercial income (either advertising based and/or subscription based) and has a PSB obligation assigned (either when the broadcast or spectrum rights were granted) which can be funded by the Government."

*4) Faza e dytë/"Switch off" - Të bëhet licencimi direkt i TV21, KTV dhe konsorciumeve të televizioneve regjionale/lokale si operatorë të rrjeteve nacionale, përkatësisht si operatorë të rrjeteve regjionale për transmetim digjital tokësor, ku TV21 dhe KTV u vazhdohet menaxhimi me frekuenca për ndërtimin e nga një MUX-i nacional secili, ndërkaq konsorciumeve të transmetuesve regjionalë dhe lokalë u vazhdohet menaxhimi i frekuencave për ndërtimin e 5 MUX-ave rajonalë. Të gjitha licencat për transmetimin analog të ripërtërihen si licenca digjitale deri në vitin 2025. (faqe 37, Kapitulli "PROCESI I IMPLEMENTIMIT TE TELEVISIONIT TOKËSOR DIGJITAL NË KOSOVË")*

#### Arsyetim:

Duke u nisur nga Legjislacioni European dhe praktikat e disa shteteve të BE gjatë kalimit në DTT, janë respektuar të drejtat e shikuesve dhe transmetuesve aktualë analog, që me ndryshim të teknologjisë, të mos shkaktohen çrregullime në treg, të adresohet drejt interesi i publikut për informim, dhe të ruhet infrastruktura ekzistuese e transmetimit, për përdorim në transmetime digjitale.

**Direktiva 2002/77/EC e Komisionit European, për konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe sherbimeve të komunikimeve elektronike:**

Neni(4) Shtetet anëtare nuk duhet të japin të drejta ekskluzive apo speciale për përdorimin e radio frekuencave për komunikime personale dhe mobile, dhe se ato duhet të jepen me procedura objektive, jo-diskriminuese dhe transparente.

Mirëpo kjo nuk i paragjykon kriteret specifike dhe procedurat e vendeve anëtare që t'i japin ato të drejta për operatorët e përmbajtjes së transmetimit radio televiziv, për t'u arritur objektivat e interesit të përgjithshëm, në konformitet me Ligjin e Unionit.

**Rekomandimi (2003)9 i Komitetit ministror të Këshillit European , Pjesa shtesë, Parimet e përgjithshme, pika (3) thotë se " Shtetet duhet të gjejnë mënyra për ta përsheptuar kalimin e shpejt nga transmetimi analog në atë digjital, duke u siguruar që të merren parasysh interesat e publikut, poashtu edhe interesat dhe brengat e të gjitha kategorive të transmetuesve, e posaçërisht të atyre jo-komercial dhe atyre regjional/lokal. Në këtë drejtim, duhet të miratohen korniza ligjore përkatëse dhe kushte të favorshme teknike e ekonomike ".**

#### **REFERENCË**

**Digit.TV Udhëzuesi për kalim në transmetime digjitale**

**(Digi.TV - Regional guidelines on how to improve legal framework / R-1.1) - 2012 , (Faqe 20, LICENCIMI I OP. TË RRJETIT)**

The big advantage of running a competitive process is that such process might attract foreign investments and would select the best competitor in a transparent way. However, a competitive process might be won by a company that is not one of the existing operators in the market, thus jeopardizing the investments already done by the existing broadcasters in infrastructure, services and programs, their experience with the local broadcasting sector and their customers.

To avoid such potential risk, several EU Countries decided to adopt a provision in their digitalization strategies and in their legal framework stating that (some or all of) the licenses for the private networks/Multiplexes should be assigned to the existing national analogue operators (the “Historical operators”) in exchange for their analogue license. In other words, the main broadcasters who had managed a frequency in the analogue environment would be automatically assigned a multiplex in the digital environment, without any tender, auction or beauty contest. The advantage of such approach is that the investments of the Historical operators are protected, as well as their viewers.

#### REFERENCË:

#### ITU GUIDELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 30, LICENCIMI I TRANSMETIMIT PER SHERBIM PUBLIK)

"Observing the licensing of DTTB and MTV services across the world, PSB on these new platforms is

arranged in the following way:

1. The PSB entity (i.e. the national public broadcaster) is assigned one or two DTTB multiplexes by *priority* (i.e. without any duty to apply for a license in a competitive bidding procedure like an auction or beauty parade). Please note that this does not include commercial/private broadcasters with a PSB obligation (see above three categories)<sup>44</sup>;
2. The PSB DTTB multiplexes are assigned at the same time as the time of assigning (a part of) the remaining commercial multiplexes, so as to ensure a complete bouquet of channels (depending on the competitive environment) and to facilitate a joined-up network roll-out and possibility to increase frequency efficiency, or alternatively;
3. The PSB DTTB multiplexes are assigned first so as to ensure PSB on the new DTTB platform and to determine the actual roll-out of this platform, independently from any commercial initiatives;
4. The PSB channels on the DTTB platform are in most cases Free-to-Air, although this does not necessarily imply that no conditional access system is applied<sup>45</sup>
5. For commercial content aggregators (i.e. individual commercial broadcasters) on the DTTB platform no PSB or any other broadcast obligations are levied (as, in most cases, the existing broadcast license for the analogue service suffices)<sup>46</sup>.
6. No PSB obligations are assigned to any MTV service provider, nor are MTV multiplexes assigned by priority to the PBS entity as, in most countries, these new MTV services are considered to be either:
  - a. Not a part of a Universal Service, and/or;
  - b. Still to be in the early stages of development.

It goes almost without saying, that defining PSB on a DTTB (or MTV if desirable) platform will cost money, especially when coverage obligations are included and the PSB entity rolls out its network first and independently from any commercial initiative.

In the case of DTTB and MTV platforms cost efficiencies can, however, be gained by shared roll-out plans, including:

1. Sharing multiplex capacity between the PSB entity and the commercial channels.

Depending on the defined PSB content the public broadcaster might not utilize the complete PSB multiplex and remaining capacity can be assigned to commercial channels<sup>(47)</sup>;

2. Sharing sites and other common infrastructure like antennas and back-up transmitters;

3. Applying jointly for building and other local permits.

<sup>42</sup> See also sections 2.1 and 2.4.

<sup>43</sup> See also section 2.9 for more details on financing PBS.

<sup>44</sup> Assigning priority rights to commercial entities can lead to serious market distortions. Moreover, it is argued that any PSB entity with advertising income distorts the market and hence should not acquire any priority rights.

Andaj, meqë me draftin e propozuar RTK-së i ipet me automatizëm licenca, përkundër pikës 44. të udhëzimeve të ITU, kërkojmë që e njëjta praktikë të aplikohet edhe tek televizionet historike.

#### **REFERENCË:**

#### **ITU GUIDELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 52, DHENIA E LICENCAVE PER TRANSMETIM TOKESOR DIGJITAL)**

"Observing the DTTB licensing assignment procedures across the world we can conclude that in almost all countries the DTTB license for Public Service Broadcasting (e.g. assigned to a Public Broadcaster) are assigned by priority and that the DTTB spectrum rights are assigned by means of a public tender or by renewal to commercial parties<sup>(95)</sup>.

<sup>REF (95)</sup> 'By priority' is referring to (Public) Broadcasters getting their digital license first, without any competition, to carry-out their digital Public Service Broadcast obligation. This might entail that they can offer more services as compared to the analogue situation. The remaining digital spectrum is then assigned to ther commercial interested parties/bidders. 'Renewal' is referring to (commercial) analogue television licence holders getting their license/analogue rights 'converted' to a digital license enabling them to at least continue broadcasting their current program(s) after ASO. This might result in spectrum efficiencies if the digital license holder only facilitates a limited number of channels

5). Tek rekomandimet për assignments (KAPITULLI 3, KORNIZA TEKNIKE, faqe 26 dhe 27 e Strategjisë) të përfshihen edhe pikat ekzistuese të transmetimeve regjionale/lokale, si pika për planifikim të rrjeteve primare dhe sekondare, e po ashtu edhe pika të tjera të cilat konsiderohet të jenë interes kombëtar i Kosovës.

#### Arsyetim

Duke u bazuar në Direktivën për Shërbime Universale për çmim të arsyeshëm të shërbimeve për konsumatorë, Direktivën Kornizë, për qasjen në rrjetet e komunikimeve elektronike, është interes i publikut, rregullatorit dhe operatorëve që të përfshihet infrastruktura ekzistuese e transmetimeve analoge, për ndërtimin e rrjeteve për transmetim tokësor digjital. Po ashtu dokumenti i "Strategjisë për kalim..." në faqe 25, përmend 20 pika të transmetimit (6 kombëtare dhe 14 lokale/rajonale), por të njëjtat nuk përfshihen si assignments në faqe 26 dhe 27 për rrjetet kombëtare apo rajonale.

#### **REFERENCË:**

#### **ITU GUDIELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 202, Planifikimi frekuencor dhe topologjia e rrjetit)**

"Analogue TV sites are in general also used for DTTB, for reasons of economy.

However, additional stations may be needed in cases where:

- The analogue TV network does not cover the complete wanted coverage area;
- Portable or mobile reception is an important requirement and:
  - because of the high required field strength and regulatory or practical power limitations power distribution, using SFNs, is applied;
  - existing sites, planned for roof top reception, are situated too far from population centers.

On the contrary, experience has shown that, for DTTB, fewer fill-in transmitters are needed than for analogue TV.

The technical characteristics of DTTB stations and analogue TV stations should be in accordance with the GE06 Agreement. The GE06 Agreement contains two Plans, a digital Plan and an Analogue Plan "

**Direktiva 2002/77/EC** e Komisionit Europian, për konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në nenin (2) thotë se "Vendet anëtare nuk do të japin të drejta ekskluzive apo speciale për ndërtimin apo shfrytëzimin e rrjeteve për komunikime elektronike, që përdoren për shërbime të komunikimeve elektronike që janë për qasje publike. Vendet anëtare duhet të sigurojnë që nuk do të vendosen ose mbahen kurrfarë ndalesash që shërbimet e komunikimeve elektronike të kryhen përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike të ndërtuara nga operatorët e komunikimeve elektronike apo nga palë të treta. "



6). Të ndryshohet ndarja aktuale transmetimit regional të rrafshit të Kosovës nga tri suballotmente, në një. (KAPITULLI 3, KORNIZA TEKNIKE, faqe 26 dhe 27 e Strategjisë)

Kërkohet që ndarja regionale të bëhet në dy sub-allotmente:

- Suballotmenti i Kosovës dhe
- Suballotmenti i Dukagjinit

Suballotmenti i Kosovës duhet të përfshijë komunat e regjioneve: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan, ndërkaq suballotmenti i Dukagjinit të përfshijë komunat e regjioneve Pejë, Gjakovë dhe Prizren.

Ndërkaq të planifikohet edhe niveli i trete, i rrjeteve të MULTIPLEKSEVE LOKALE, ku përfshihet Suballotmenti Prishtina

#### Arsyetim:

- Ndarja e propozuar për rrafshin e Kosovës në tri suballotmente + suballotmenti i Kryeqytetit është në kundërshtim me shpërndarjen reale të valëve elektromagnetike në rrafshin e Kosovës dhe me planifikimin e rrjetave të referencës (forma e allotmentit). Planifikimi i (sub) allotmentit duhet të jetë konform zonës së shërbimit.
- Sipas parimeve të dala nga RRC-06 sinjali digjital i televizioneve historike (edhe atyre rajonale e lokale) duhet të mbulojë të paktën shtrirjen e tyre të mëparshme që ishte në modin analog. Kjo ndarje cungon mbulueshmërinë e licencuar të 9 televizioneve rajonale/lokale që veprojnë në rrafshin e Kosovës.
- Duke cunguar mbulueshmërinë e licencuar, sinjali i këtyre televizioneve duhet të përsëritet po aq here neper multipleksa të ndryshëm, që për planifikimin e rrjeteve SFN është shfrytëzim joracional i spektrit, e kjo është në kundërshtim me deklaratimet e kësaj strategjie.
- Në diku rreth 40% të territorit, për shkak të palosjes së sinjaleve (overlapping) nga dy apo tre multipleksa rajonalë (shembull në Prishtinë, Ferizaj, dhe pjesën më të madhe të këtij rrafshi), tek ana e pranuesve përsëritet programi i njëjtë disa here, që është dëmtrim i tregut (konkurrencë jolokale) dhe humbje e panevojshme e spektrit. Kjo implikon edhe rritjen e çmimit të bartjes së sinjalit të televizioneve rajonale për tri deri katër herë, që në këto rrethana ekonomike, e pamundëson transmetimin rajonal apo lokal.
- Ndarja në dy suballotmente do të bënte edhe balancimin e popullatës së mbuluar
- - Suballotmenti Kosova = ~ 1 milion banorë
- - Suballotmenti Dukagjini = ~800,000 banorë.
- Ndarja e suballotmenteve në Strategji, në formën që është, aplikon standarde të dyfishta për përcaktim numrit të sub-allotmenteve dhe zonës së tyre, duke zbatuar rekomandimet e ITU dhe parimet e kalimit në DTT në zonën e Rrafshit Dukagjinit, me rritje të mbulueshmërisë së transmetuesve që operojnë në atë zonë. Ndërkaq në anën tjetër, strategjia e njëjtë i shkel ato parime tek transmetuesit në rrafshin e

Kosovës, duke ua cunuar zonën ekzistuese, që është në kundërshtim me hartën e licensuar të mbulimit të tyre, interesin publik të shikuesve dhe të vetë transmetuesve. Për këto arsye, kjo ndarje ishte kundërshtuar në Grupin teknik për Startegji, nga të gjithë transmetuesit rajonal dhe lokal të Kosovës, përfshirë edhe transmetuesit televiziv që transmetojnë në gjuhë të minoriteteve.

- Ndarja e subballotmenteve në Strategji, në formën që është, deklaroi se ndarja është bërë në disa kritere (gjeografike, demografike, ekonomike, etj), duke mos iu referuar asnjë dokumenti apo analize relevante, dhe në kundërshtim me çfarëdo ndarje administrative të njohur në RKS.

**REFERENCË:**

**ITU GUIDELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 28, KORNIZA E LICENCIMIT)**

"Spectrum management objectives: In order to increase spectrum efficiency the Regulator would like to avoid content duplication"

**REFERENCË:**

**ITU GUIDELINES FOR TRANSITION FROM ANALOGUE TO DIGITAL BROADCASTING (FAQE 202, Planifikimi frekuencor dhe topologjia e rrjetit)**

"Service areas for national, regional and local services need to be clearly defined. A high number of regional or local areas leads to extra costs regarding re-multiplex centers or links; if possible the number of regions should be limited.

The choice of re-multiplex locations depends on operational considerations, costs of multiplex equipment and the costs of links. The latter may differ considerably from country to country or part of the country. In general the location of encoders and (re) multiplexer is close to a studio play-out centre in order to obtain relative short distances for the uncompressed signals."

7). Për transmetim regional dhe lokal, të licencohen fillimisht pesë mux regjionale (tri (3) në rrafshin e Kosovës nga grupimi i transmetuesve rajonal/lokal të Kosovës dhe dy(2) në rrafshin e Dukagjinit nga grupimi i transmetuesve rajonal/lokal i Dukagjinit), të cilat funksionojnë në parimin SFN me topologji RN1 dhe RPC2.

Të përcaktohen kanalet e mukseve rajonale, si zëvendësim i planit analog, me karakteristika teknike të transmetimit, për të cilat nuk paraqitet nevojë për koordinim ndërkombëtar me shtetet fqinje, si dhe të cilat evitojnë shpenzimet e panevojshme për akordim të sistemit të antenave tek transmetuesit dhe tek publiku.

#### Arsyetim:

Strategjia për kalim në transmetime digjitale, në formën që është, nuk garanton vazhdimësi të operimit të transmetuesve rajonalë dhe lokalë, për këto arsye:

- Nuk është e përfshirë infrastruktura e tyre ekzistuese në implementimin e rrjeteve digjitale,
- Nuk janë përcaktuar lokacione të transmetimit dhe frekuenca që mundësojnë vazhdimin e menjëhershëm të transmetimeve regjionale pa shkaktuar interferenca. Transmetimi regional në mënyrë të panevojshme i është lënë fatit të koordinimit me shtetet fqinje, proces që mund të zgjasë me vite,
- Nuk është garantuar kontinuiteti i programeve regjionale gjatë fazave të implementimit të kësaj strategjie
- Përcaktimi i pesë mukseve për transmetimin regjional do të siguronte transmetimin e të gjitha programeve të transmetuesve rajonalë/lokalë edhe në teknikën HD, por dhe hapësirë rezervë për implementimin eventual të rregullës "Must Carry" për televizionet e reja regjionale/lokale të licencuara nga KPM.

#### **REFERENCË:**

Sipas Kapitullit 4 të Akteve Finale, RRC-06, neni 4.1.2, pika 4.1.2.1 thote se duhet te kete koordinim me administratat(fqinje) **nese me ndryshimet e PLANIT afektohen sherbimet e transmetimeve apo sherbime te tjera primare te rregulluara nga ato administrata. Ne rastin e rrjeteve rajonale me RN1, KPM nuk licenson fuqi, lartesi apo/dhe drejtim te propagimit radiodifuziv qe i afekton ato sherbime te fqinjeve(Aneksi IV, seksioni I per nivelet e mbrojtjes se sherbimeve, RRC-06). Propozohet qe per allotmentin e Rrafshit te Kosoves te perdoren kanalet 25, 33, 50 apo 56 nderkaq per rrafshin e Dukagjinit kanali 28 dhe 52, pasi qe keto kanale jane te pakten ne 60 km distance nga allotmenetet me kanale te njejta te shteteve fqinje**

*8). Të parashihet edhe kategoria e nivelit të tretë të rrjeteve digjitale, atij të transmetimit lokal (përshirë këtu edhe suballotmentin e Prishtinës, me dy apo tri muxe lokale)*

Arsyetim:

Shih arsyetimin tek pika 5).

*8) . Mukset rajonale 1 deri 5 të jenë të licencuara si MUX-e Free-to-Air, programin e të cilëve shikuesi mund ta shikojë pa ndonjë parapagim apo pagesë të veçantë.*

Arsyetim:

Pasi që shumica e transmetuesve rajonalë kategorizohen edhe si transmetues me përmbajtje për shërbim publik (PSB), është interes i publikut dhe transmetuesve që të vazhdojnë më të njëjtën mundësi të qasjes falas në programet e tyre nga publiku, dhe udhëzuesit e përmendur më lartë (ITU, OSCE dhe Digitag) i rekomandojnë rregullatorit që të vendos në interesin më të mirë të publikut.

9). *KPM, me anë të një akti nënligjor, të rregullojë nivelin e pagesës së taksës për licensë të MUX-ave rajonale, konform mundësive reale të transmetuesve rajonalë/lokalë dhe konform fuqisë së tyre në treg, me mundësi të rishikimit vjetor. (Faqe 43, i "Strategjia.." Pika 1. Krijimi i bazës ligjore për licencim)*

10). *Të definohet statusi "Must carry" për transmetuesit aktualë analogë që nuk duan të marrin pjesë në ndërtimin e rrjeteve digjitale, si dhe për ofruesit e ri të përmbajtjeve në nivel nacional/regjional/lokal.*

11). *Në faqe 28 të "Strategjisë..", tek Tabela 5, kanali 48 nuk e ka statusin e frekuencës së lirë.*

12). *Në faqe 43 të "Strategjisë..", KAPITULI VII, Plani i implementimit, të modifikohen afatet kohore konform ndryshimeve të kërkuara në strategji nga transmetuesit e licencuar të Kosovës, dhe në pajtim me rekomandimet e ITU për përcaktimin e datës ASO.*

13). *Të planifikohet njëri MUX në VHF për implementimin e transmetimeve DVB-T2 LITE, dhe hartimi i një akti nënligjor për licencimin dhe përdorimin e tij.*

## **PJESA E DYTË : VIZIONI I AMPEK-ut**

### **PARIMET E PËRGJITHSHME DHE QËLLIMET**

- Përmirësimi i konsiderueshëm i kualitetit të pranimit të sinjaleve TV, dhe mbulueshmërisë së popullatës në tërë territorin e RKS (të paktën 85% e popullatës), përmes ngritjes së rrjeteve SFN në nivel kombëtar dhe kombëtar dhe rajonal.
- Zgjerimi i ofertës programore për publikun, me prezentimin e ofertave të reja programore
- Racionalizimi i shfrytëzimit të spektrit të transmetimeve tokësore dhe alokimi i pjesës së epërme të bandit UHF për dividendë (mbi 800MHZ).
- Promovimi i teknologjive të reja dhe që nuk kufizohen vetëm në DVB-T/T2, Mpeg4, HD dhe UHD dhe 3D
- Sigurimi i minimumit të nevojshëm të multipeksave dhe programeve për shikim pa pagesë (FREEVIEW) në nivel nacional dhe rajonal/lokal
- Subvencionimi i pranuesve për publikun, sipas përvojës në rajon e më gjerë
- Rregullimi i ndarjes së tregut, evitimi i monopoleve në njërin anë por edhe dëmtimit/rënies së tregut për shkak të licencimit të pakontrolluar në anën tjetër, nëpërmjet akteve nënligjore në pajtim me ligjet në fuqi, si dhe monitorimit të rregullt vjetor të tregut nga rregullatori.
- Ruajtja dhe zhvillimi i kanaleve historike përmes së drejtës për transmetim digjital dhe licencim të garantuar të transmetuesve të licencuar si ofrues të shërbimeve programore me licencë 15 vjeçare.

Kjo realizohet përmes aplikimit të modelit hibrid gjatë licencimit të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve audiovizuale, ku rregullatori përcakton kushtet minimale për licencim direkt të kanaleve historike(nacionale dhe regjinale/lokale) si operatorë të multiplekseve, kushtet për tenderim të frekuencave të liruara si dhe legjislacionin sekondar përcjellës.

- Përfshirja dhe përkrahja e industrisë së medias për procesin e digjitalizimit
- Inkorporim sa më gjithëpërfshirës i infrastrukturës dhe pikave ekzistuese të transmetimit televiziv në rrjetet DVB
- Nisja sa më e shpejtë e transmetimeve digjitale eksperimentale dhe lansimi i fushatës për informim publik
- Ndihmesë në proceset dhe projektet për subvencionim të transmetuesve të licencuar të Kosovës me grante shtetërore apo ndërkombëtare për ndërrim të teknologjisë
- Krijimi i një forumi koordinues (forumi DVB KS) ndërmjet rregullatorit dhe lojtarëve të tjerë (operatorët, ofruesit e programeve, përfaqësues të konsumatorëve, qeveria) për koordinim të standardeve të transmetimit, pranimit dhe për mundësim të interoperabilitetit.

Për t'u përmbushur këto parime dhe që të realizohen qëllimet e lartshënuara propozohet si vijon:

## RRJETET

- Të bëhet ndarja e rrjeteve të transmetimit në rrjetet primare dhe sekondare

**Rrjetet primare** përbëhen nga transmetuesit e sinjaleve të cilat ndodhen në pikat e caktuara me kritere teknike të cilat janë apo mund të bëhen pjesë e planit të ITU për Kosovë (National Assignments). Këto pika kryesisht transmetojnë sinjale të cilat mund të depërtojnë jashtë zonës së ridefinuar për Kosovë dhe mund të jenë subjekt i negociatave me fqinjët për çështjen e fuqisë dhe të orientimit të sistemit të antenave. Këto rrjete u nënshtrohen parametrave për rrjetet e referencës RN1

**Rrjetet sekondare apo regjionale** janë të gjitha pikat tjera të transmetimeve, sinjalet e të cilave sipas kritereve teknike të përcaktuara, nuk depërtojnë përtej zonës së kufizuar për territorin e RKS, përfshirë këtu edhe transmetuesit plotësues (Gap fillers). Sipas RRC-06, pikat e transmetimit nga këto rrjete nuk kanë nevojë për koordinim ndërkombëtar me shtetet fqinje apo ITU. Këto rrjete u nënshtrohen parametrave për rrjetet e referencës RN1, RN2 dhe RN3. Këtu nuk përjashtohen edhe pikat e transmetimit nga rrjetet primare, mirëpo me parametra teknik (drejtim/elevacion të antenës dhe fuqi ERP) konform rrjeteve të referencës RN2 apo RN3.

Është interes kombëtar i Kosovës që këto pika të transmetimit (Assignments) të identifikohen nga KPM dhe shteti i Kosovës si pika esenciale për transmetim tokësor digjital. Kështu mundësohet koncentrimi i rregulluar i infrastrukturës transmetuese në këto pika si resurse të limituara të Kosovës, pranimi i më shumë programeve nga një drejtim, parandalohet kaosi infrastrukturor dhe mbrohet popullata nga rrezatimi elektromagnetik i pakontrolluar:

Assignments	Latitude	Longitude	Altitude m	Antenna height m	ERP kW	Direction	Type
Cernushë	N 42. 53' 08"	E 20. 55' 06"	996	50	60	0	Primar
Golesh	N 42.34' 10"	E 20. 58' 37"	1017	75	60	0	Primar
Vreshta	N 42.40' 22"	E 21.10' 51"	723	30	10	0	Lokal 2
Leposaviq	N 43.05'44"	E 20. 47' 08	632	30	30	60+150	Lokal 2
Mali Zvecan							Lokal 2
Leshak	N 43. 09' 45"	E 20. 42' 05"	1052	30	10	0	Primar
Feriqevë (Kamenicë)	N 42.37' 40"	E 21. 35' 40"	816	40	30	0	Lokal 2
Kranidell	N 42.35'29"	E 21. 41'10"	880	30	30	240+30	Primar
Maja e Gjelber	N 42.32'18"	E 21.29' 12"	995	50	60	0	Primar



Komentet për digjitalizimin • AMPEK • 23 janar 2015

Koliq	N 42.44' 18"	E 21.16' 00"	1018	30	60	0	Primar
Ferizaj	N 42.23' 08"	E 21.07' 24"	645	30	30	0	Lokal 2
Gajre	N 42.11' 47"	E 21.14' 38"	883	50	30	0	Lokal
Kotlinë	N 42. 09' 38"	E 21. 12' 21"	1008	50	30	270+ 60	Lokal 2
Pustenik	N 42.09' 09"	E 21.16' 25"	856	30	5	60+150	Lokal
Piribreg	N 42.10' 13"	E 21.02' 29"	2188	20	30	330+60	Primar
Zatriq	N 42. 26' 44"	E 20. 37' 19"	1019	50	60	0	Primar
Zym	N 42. 16' 43"	E 20. 37' 45"	648	30	30	0	Lokal 2
Cvilen	N 42. 10' 21"	E 20. 44' 34"	1376	30	30	0	Primar
Peja Sillos F-ka	N 42. 39' 33"	E 20. 18' 58"	496	50	30	0	Lokal 2
Kurilo	N 42. 51' 15"	E 20. 39' 47"	1399	62	30	120+180 +240	Primar
Gllobocice	N 42.00' 00"	E 20. 37' 39"	1325	30	10	0	Lokal 2
Berishe	N 42. 32' 04"	E 20. 51' 04"	1014	50	20	0	Primar
Cermjan	N 42. 29' 26"	E 20. 27' 43"	682	30	30	0	Lokal 2
Restelicë	Local			30	5	0	Lokal
Zubin Potok	Local			30	5	0	Lokal

## OPERATORËT E MULTIPLEKSEVE

- Për arsye të tregut të vogël, thjeshtësisë teknike të operacionit, dhe kostos më të ulët për publikun dhe për ofruesit e programeve, propozohet që operatorët e rrjetit të jenë edhe përgjegjës për menaxhimin e multipleksave, duke mos përjashtuar edhe mundësinë që të jenë edhe ofrues të përmbajtjeve audiovizuale, me kusht që të kenë kontabilitetet e ndara.  
KPM miraton aktet nënligjore më të cilat rregullohen licencim i përmbajtjeve në multipleksin publik, multiplekset Freeview dhe multiplekset PayTV.
- Krahas RTK-së, si operator i rrjetit publik (**MUX A**), të garantohet edhe licencimi i të paktën dy operatorëve të rrjeteve primare dhe të paktën dy operatorëve të rrjeteve sekondare me licencë 15 vjeçare. Kështu sigurohet që në të gjitha zonat e Kosovës në çfarëdo konstelacioni, shikuesve mund t'u ofrohen 6 SFN multipleksa nacional (1 Rezervë) dhe të paktën 4 multipleksa SFN rajonal nga operatorë të ndryshëm, promovohet konkurrenca në transmetime digjitale dhe pluralizmi i pronësisë së mediave.
- Të bëhet licencim direkt i televizioneve historike të Kosovës si operatorë të multiplekseve:  
**MUX(B)** RTV 21 SFN Nacional  
**MUX(C)** KTV SFN Nacional  
**MUX R1, MUX R2** dhe **MUX R3** SFN Rajonal (TV TEMA, FESTINA, LIRIA, ILIRIA, VALI, MEN, PULS, HERC, MITROVICA, MIR, MOST, TV MAX)  
**MUX R4, DHE R5**, SFN Rajonal (TV OPINION, TV PRIZRENI, TV BESA, BALLKAN TV, TV SYRI, TV DUKAGJINI)

Në bazë të vlerësimit vetjak të AMPEK-ut, infrastruktura ekzistuese transmetuese e transmetuesve komerciale në Kosovë (KTTN + TV regjionale dhe lokale) tejkalon vlerën prej 4 milionë euro (duke mos e përfshirë edhe teknikën e studios dhe terrenit). Licencim i kanaleve historike si operatorë për transmetime digjitale dhe përfshirja e infrastrukturës ekzistuese të pikave të transmetimit analog në Kosovë në transmetime digjitale është e domosdoshme dhe e arsyeshme pasi që sigurohet infrastruktura e gatshme, vazhdimësi e përmbajtjeve programore dhe zvogëlohet dëmi që u shkaktohet mediave me investime mandatore në teknologji të re. Kjo arrihet përmes licencimit direkt të dy transmetuesve komerciale nacionalë si operatorë të multipleksit FREEVIEW (MUX B dhe MUX C) në frekuenca të veçanta që tani i kanë në përdorim analog, dhe licencimit të konsorciumit të mediave regjionale/lokale si operatorë të katër multiplekseve regjionale FREEVIEW (MUX R1, R2, R3, R4 dhe R5) në pesë frekuencat analoge përkatëse të cilat tashmë i kanë në shfrytëzim.

Pasi që në vitin 2011 industria e TV kabllor në Kosovë kishte tejkaluar pjesëmarrjen në treg krahasuar me të hyrat komerciale të TV tokësore (13.6 milionë euro Cable TV, krahasuar me 10.2 milionë euro për Terrestrial TV), modeli i propozuar i licencimit hibrid është edhe domosdoshmëri për të ruajtur diversitetin e tregut dhe për të evituar koncentrimin e kapitalit.

Modeli hibrid i licencimit të operatorëve të multipleksave në Kosovë gjen edhe përkrahjen e plotë të industrisë televizive për lirimin e shpejtë të frekuencave në përdorim analog, dhe licencimin e operatorëve të ri përmes procesit të tenderimit për frekuencat e liruara, sipas direktivës europiane.

Po ashtu ky model i garanton publikut Kosovar vazhdimësinë e shikimit të TV pa pagesë, me ofertë më të gjerë dhe më kualitative.


KPM përcakton kriteret teknike, afatet dhe kushtet për shfrytëzimin e multiplekseve FreeVIEW, përmes rregullores për përmbajtje në multipleks, rregullores për renditjen Logjike (LCN) dhe Must Carry për ofruesit e tjerë apo të ri të përmbajtjeve.

- Për të mundësuar vazhdimësinë e transmetimit lokal, KPM mund të alokojë edhe frekuenca lokale me fuqi të vogël për servise me një program (SPS - Single Program Service) apo edhe me shumë programe (MPS - Multi program Service) për lokacionet: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Shtërpçë dhe Leposaviq.
- Për të parandaluar koncentrimin e kapitalit dhe krijimin e monopoleve, KPM duhet të kufizojë (në %) pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë të licencuar nga KPM apo ART (operatorët e rrjeteve kabllore dhe të telefonisë mobile) në pronësi të operatorëve të rrjetit DTT.
- Duhet të sigurohet interoperabiliteti ndërmjet operatorëve, në mënyrë që shikuesi mos të ketë nevojë për ndërrim të pajisjes pranuese që të kalojë pranimin nga njëri operator në tjetrin.
- KPM siguron transparencë të plotë të pronësisë së operatorëve të rrjeteve DTT dhe ofruesve të shërbimeve audiovizuale, për të parandaluar shpëlarjen e parave dhe financimin e organizatave terroriste.
- RTK ja të licencohet si operator publik dhe të jetë përgjegjëse për dy multipleksa, multipleksin publik A dhe multipleksin rezervë R.
- Të ndalohet bartja e programeve me pagesë (PAY-TV) në multipleksin e RTK-së, dhe shfrytëzimi fitimprurës i këtij multipleksi.
- Në rast të kërkesave nga ofruesit e licencuar të programeve me interes publik (televizionet komerciale nacionale, regjionale dhe të komunitetit), RTK obligohet t'u gjejë hapësirë në multipleksin e vet përmes një procesi të përzgjedhjes dhe kjo rregullohet me licencë nga KPM dhe me akte nënligjore.

### **Faza e Simulcastit (Faza e I-rë), multipleksët Freeview**

Në bazë të parimeve që derivojnë nga RRC-06, KPM është e obliguar që të gjithë transmetuesve TV analogë t'u ofrojë mundësinë e fillimit të testeve në DVB, sa më shpejt që është e mundshme.

Kështu për transmetuesit me mbulim analog nacional (RTK-TV21-KTV), duhet të alokohen tri frekuenca nga plani RRC-06, dhe të bëhen testet e para të mbulimit me multipleks SFN nga pikat ekzistuese të transmetimit të operatorit analog KTTN, përfshirë edhe pikat e tjera nga rrjeti primar dhe regional i transmetimeve digjitale.




MUX A, B, C, D, E, F, DHE REZERVË SFN NACIONAL (RN1)  
(janë të paraqitura vetëm pikat me fuqi më të lartë ERP)

Ndërkaq për TV transmetuesit aktualë me mbulim analog regional/lokal, KPM duhet të alokojë 5 frekuenca të rangut rajonal (3 për rrafshin e Kosovës dhe 2 për rrafshin e Dukagjinit) dhe të mundësojë transmetimin testues të multiplekseve të përkohshme SFN në nivel lokal 2.


Për transmetim regional propozohet ndarja në dy regjione:

**Rrafshi i Kosovës** (komunat në lindje të vijës imagjinare Prevallë - Berishë-L. Ujman (Gazivodë)) dhe

**Rrafshi i Dukagjinit** (komunat në perëndim të vijës imagjinare Prevallë-Berishë-L. i Ujman)



**MUX R1, R2, DHE R3, SFN Regional RN1**



**MUX R4, dhe R5, SFN Regional RN1**

Me transmetimin në dy modet njëkohësisht, analog dhe digjital, shikuesit mund të informohen për fazën testuese dhe benefitet e televizionit digjital, ndërkaq televizionet dhe furnizuesit e risiverëve, STB-ve apo pranuesve televizivë DVB-T apo DVB-T2 mund të bëjnë teste të pranimit me teknologji të re.

Me transmetim testues, KPM dhe ekspertët teknikë të palëve të interesuara mund të bëjnë matje, analiza dhe përgatitje të duhura teknike për fazën e dytë (FAZA II - ASO).

Propozohet ky konstelacion i multiplekseve:

SFN Nacional:

KANALI	PËRSHKRIMI	MPX ID
07	MULTIPLEX A (RTK)	MXA
21	MULTIPLEX B (TV21)	MXB
31	MULTIPLEX C (KTV)	MXC
44	MULTIPLEX (TENDER) D	MXD
46	MULTIPLEX (TENDER) E	MXE

<b>48</b>	MULTIPLEX (TENDER)	F	MXF
<b>58</b>	RESERVE (RTK)		MXR

SFN Rajonal (Rrafshi i Kosovës):

KANALI	PËRSHKRIMI	MPX ID
<b>23</b>	TV REGJ/LOK. REG-1A	MXREG1A
<b>50</b>	TV REGJ/LOK REG-1B	MXREG1B
<b>42</b>	TV REGJ/LOK REG-1C	MXREG1C

SFN Rajonal (Rrafshi i Dukagjinit)

KANALI	PËRSHKRIMI	MPX ID
<b>28</b>	REG-2A	MXREG2A
<b>52</b>	REG-2B	MXREG2B

### Faza ASO

Pas shuarjes së transmetimit analog dhe lirimit të frekuencave, mund të fillojnë punën edhe 3 multipleksat SFN kombëtar D, E, F në bazë të kërkesave dhe nevojave të publikut/tregut.

Në strategji duhet të parashihet mundësia që në të ardhmen të rritet numri i Multipleksave SFN varësisht nga negociatat me ITU dhe me shtetet fqinje.

Është praktikë europiane që transmetuesit publik, në këtë rast RTK të investojë dhe të mbajë edhe multipleksin R si multipleks rezervë (redundant), i cili aktivizohet vetëm në rastet e caktuara si zëvendësues në rast të problemeve teknike në Multipleksat aktivë A-F.

## **PARAMETRAT TEKNIKË**

### **TRANSMETIMI DTT - RRJETI SHPËRNDARËS**

Duke marrë parasysh praktikat e fqinjëve për parametrat teknik të implementuar gjatë transicionit nga transmetimi analog në atë digjital, AMPEK-u rekomandon implementimin e modulimit DVB-T dhe fillimisht enkodimit Mpeg-4 level 10 (H.264/AVC) duke mos përjashtuar enkodimet e reja (H.265)

Modulimi DVB-T, edhe pse i takon gjeneratës së parë, është më i lehtë, më i lirë dhe më i shpejtë për implementim. Duke pasur parasysh trendet e zhvillimit të enkodimeve të reja të sinjalit bazë (H.264, H.265), implementimi DVB-T tejkalon nevojat afatgjate të publikut Kosovar për programe televizive.

### **RRJETI KONTRIBUES**

AMPEK-u rekomandon imlementimin e rrjeteve TS over IP, duke mos përjashtuar edhe radio -linkat digjital DVB ose IP, apo sinjalin satelitor për implementim të rrjeteve kontribuuese, me qëllim të ndërtimit të multiplekseve.

AMPEK-u rekomandon që KPM të negociojë me ARKEP-in një status të beneficuar për operatorët e multiplekseve gjatë përcaktimit të tarifave për shfrytëzim të frekuencave telekomunikuese për ndërtim rrjeteve apo lidhjeve kontribuuese.

### **FORUMI DVB KOSOVA**

AMPEK-u rekomandon që KPM të iniciojë krijimin e një forumi koordinues (forumi DVB KS) ndërmjet rregullatorit dhe pjesëmarrësve të tjerë në transmetimin digjital (operatorët, ofruesit e programeve, përfaqësues të konsumatorëve, qeveria) për koordinim të standardeve të transmetimit, pranimit dhe qasjes së kufizuar.